

KRITIKË DHE BIBLIOGRAFI

ANILA OMARI

**REXHEP ISMAJLI, *DREJTSHKRIMET E SHQIPES,*
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË, TIRANË 2021**

Në vitin jubilar të sanksionimit të drejtshkrimit aktual të shqipes, Akademia e Shkencave i bën dhuratë publikut të interesuar librin e prof. Rexhep Ismajlit ‘Drejtshkrimet e shqipes’, një libër që po mungonte prej kohësh në Kosovë që nga botimi i parë i vitit 2005, ndërsa në Shqipëri thuajse nuk kishte qarkulluar, përveç se në pak duar specialistësh. Libri është një pasqyrë e përpjekjeve më se njëshekullore të intelektualëve, filologëve e sidomos gjuhëtarëve më të shquar shqiptarë për të njësuar gjuhën shqipe e për t’i dhënë asaj një drejtshkrim të përshtatshëm. Ai përshkruan rrugën e vështirë përmes së cilës kaluan punëtorët e planifikimit gjuhësor të shqipes, pengesat dhe kontradiktat që përmbante një proces i tillë kur synohej të krijohej një gjuhë e vetme letrare e përbashkët për të gjithë shqiptarët, në kushtet specifike të shqipes me dy variantet kryesore të saj që për një kohë të gjatë kishin ecur secili në drejtimin e vet dhe kishin krijuar variantet përkatëse letrare. Autori paraqet në mënyrë objektive por edhe me vështrim kritik etapat e veçanta të planifikimit gjuhësor të shqipes përmes analizës së mendimeve e pikëpamjeve të secilit nga aktorët kryesorë të këtij procesi, për të vlerësuar në fund të fundit pozitivisht punën e madhe dhe energjinë e shpenzuar nga breza të tërë studiuesish për të arritur në gjendjen e sotme të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe. Studimi hyrës i paraprin botimit të drejtshkrimeve kolektive të shqipes që nga rregullat e drejtshkrimit të Komisionit letrare të Shkodrës 1917 e deri te Drejtshkrimi i gjuhës shqipe i vitit 1973 i dalë mbas Kongresit të Drejtshkrimit, gjithsej 14 materiale të riprodhuara në mënyrë të plotë e besnike të origjinalit. Lexuesit në këtë mënyrë i jepen të gatshme të gjitha përpjekjet drejtshkrimore të bëra si projekte kolektive, për të gjykuar edhe vetë mbi to, krahas përfundimeve të vetë autorit, dhe për të ndërmarrë eventualisht studime me tematika të veçanta për çështje të ndryshme që dalin nga drejtshkrimet e botuara në libër.

Ky botim i dytë është i rishikuar nga autori dhe përmban një drejtshkrim më tepër në krahasim me botimin e parë, atë të jezuitit italian Adone Aldegheri të vitit 1927, i cili nuk ishte përfshirë në botimin e parë.

*

* *

Tradita shkrimore e shqipes që nga dokumentet dhe tekstet e para të shekujve XV-XVII, në vetvete është një shumësi përpjekjesh individuale standardizuese të secilit autor që merr të shkruajë gjuhën e vet dhe që dëshiron të jetë i kuptueshëm nga një masë më e gjerë lexuesish sesa rrethi i ngushtë i vendlindjes së vet. Autori i librit që po paraqesim nuk mungon ta prekë këtë lloj normalizimi kryesisht implicit, nga praktika shkrimore, por ndonjëherë edhe të shprehur përmes shënimeve shpjeguese drejtshkrimore, të traditës së hershme letrare me bazë gegërishten veriore, e cila krijoi një lloj koineje në shkrim, sipas përcaktimit të Eqrem Çabejt, për të vazhduar me veprimtarinë njësuere dhe integruere kombëtare të Rilindjes dhe ndërmarrjet gjuhësore të veprimtarëve të saj Sami Frashëri, Kristoforidhi, më pas Konica, Gurakuqi, Xhuvani etj.

Analiza e mirëfilltë e drejtshkrimeve e projekteve drejtshkrimore të shqipes në libër fillon që me Kongresin e Manastirit si një kurorëzim i përpjekjeve të Rilindjes në ndërtimin e një gjuhe të përbashkët letrare. Përfundimi i kësaj analize thekson rëndësinë largvajtëse të vendimeve të Kongresit të Manastirit për çështjen e alfabetit, ku u mor për bazë analiza e Sami Frashërit përgjithësuese për toskërishten, në të cilën nuk shënoheshin gjatësia e zanoreve dhe hundorësia e tyre, duke përvijuar kështu një model të ardhshëm të shqipes standarde pa këto elemente karakteristike të gegërishtes.

Projekti i parë serioz kolektiv për rregullat e drejtshkrimit të shqipes mund të themi se është ai që doli nga Komisia letrare e Shkodrës e viteve 1916-1918. Autori i kushton vëmendjen e merituar veprimtarisë me rëndësi afatgjatë të Komissës Letrare, vendimeve të saj drejtshkrimore që, duke kërkuar ruajtjen e formave më të vjetra, njëkohësisht synonin një afrim të variantit letrar gegë drejt toskërishtes në shkrim, si dhe vendimit për sa i përket varietetit dialektor që do të vihej në bazë të gjuhës letrare, që siç dimë ishte dialekti i Elbasanit si “urë midis dy dialekteve”. Një dokument me interes që silllet këtu është një letër e Atë Gjergj Fishtës dërguar konsullit austro-hungarez August Kral, përkthyer në shqip nga autori, që nxjerr në pah pikëpamjet e Fishtës për gjuhën letrare shqipe, siç ishte parimi për një gjuhë me bazë njëdialektore, të papërzier në mënyrë hibride me elemente të të dy dialekteve, dhe më tej konkretisht animi i tij drejt gegërishtes si bazë e gjuhës së përbashkët letrare duke dhënë dhe argumentet e veta për këtë.

Një projekt drejtshkrimor individual për t'u vënë re është ai i Aldegherit, jezuit italian me njohuri të shkëlqyera për gjuhën shqipe dhe me kontribute në hartimin e veprave leksikografike e gramatikore të shqipes.

Autori sjell në vëmendje diskutimet e viteve '30- mes i '40 për çështjen e gjuhës letrare, e cila, pavarësisht nga vendimet e Komisionit Letrare, në praktikë përdorej të paktën në tre variante, elbaskanishte, shkodranishte e toskërishte letrare. Lexuesi njihet me mendimet e Mustafa Krujës, që ishte gjithashtu kundër konceptit të përzjerjes dialektore dhe për t'i dhënë përparësi gegërishtes së mesme, me qëndrimin e Namik Resulit për “gegërishten e toskëruar”, pra për një përzjerje dialektesh, ku bien në sy disa pohime me vlerë sociolinguistike të tij për fitimin e një prestigji të gegërishtes së mesme ndër qarqet e mesme intelektuale e duke zbritur edhe te klasat më të ulëta si pasojë e disa faktorëve, si ardhja e kryeqytetit në Gegëri, ndikimi i Normales së Elbasanit dhe figurës së drejtuesit të saj Aleksandër Xhuvanit, lëvrimi më i thellë e më sistematik i gegërishtes sidomos nga pikëpamja e leksikut, afërsia e dialektit të mesëm me shkodranishten e cila gëzon prestigjin e shkrimtarëve të Shkodrës. Një pohim me rëndësi i Resulit është fakti që, për shkak të pasurisë leksikore të gegërishtes falë punës së priftërinjve katolikë, “vetë toskët janë të detyruar hera herës të marrin hua fjalë nga gegërishtja...” dhe se “shumica e fjalëve të reja janë trajtuar e po trajtohen sipas shpirtit (frymës) të gegërishtes”. Këto pohime nuk janë bërë ndonjëherë objekt studimi të thelluar, por mund të konstatohen duke studiuar gjuhën e autorëve të vjetër dhe numrin e madh të fjalëve të gegërishtes veriore që kanë hyrë në gjuhën letrare e janë përgjithësuar në gjuhën e përbashkët. Këto fakte qëndrojnë në bazë të atij përcaktimit të Androkli Kostallarit të një “koineje sui generis” të toskërishtes letrare, që pavarësisht nga teprimi propagandistik që përmban, mbështetet në një realitet gjuhësor të bashkëveprimit ndër-dialektor. Nëpërmjet Resulit njihemi edhe me idetë e Konicës i cili ka ndryshuar disa herë mendim për çështjen e gjuhës letrare dhe të Lumo Skëndos që ishte për dialektin e qendrës së Shqipërisë si themel të gjuhës letrare.

Një zë i rëndësishëm në rrjedhat e standardizimit të shqipes në vitet '30 e më tej ishte ai i Selman Rizës. Autori e sheh të arsyeshme të sqarojë keqkuptimin që është krijuar lidhur me pohimin përmbyllës të artikullit të tij të vitit 1936 sipas të cilit “Shkabën e flamurit e kemi me dy krerë. Gjuhën e kombit do t'a kemi me dy kryedialekte”, si një përfundim i nxjerrë mbas një analize të të dy dialekteve në kushtet kur gjuhë zyrtare ishte gegërishtja, dhe mbështetej përparësia e saj edhe si gjuhë letrare e përbashkët. Riza me këtë rast, duke renditur e theksuar anët pozitive të toskërishtes, e mbron atë si gjuhë letrare e konsoliduar dhe që nuk meriton të mbetet në nivelin e një gjuhe të folur, pra duhet të ekzistojë si gjuhë letrare krahas gegërishtes. Nga ana tjetër autori nuk ngurron të vërë në dukje edhe aspektin kontradiktor të mendimit të Rizës, nga njëra anë kur nuk pranon një gjuhë të përzjer nga dy dialektet si

gjuhë artificiale, dhe nga ana tjetër me punën e tij për ndërtimin e një “gegërishteje të sendërgjuene” që gjithashtu është një gjuhë pak a shumë e krijuar në tavolinë, e cila në të vërtetë nuk pati sukses në praktikë.

Është e kuptueshme që vëmendja kryesore e punimit u kushtohet proceseve të planifikimit gjuhësor mbas Luftës II botërore, ku zë vend një analizë e gjerë sidomos e diskutimeve të vitit 1952 në Institutin e Shkencave në Tiranë, të zhvilluara në frymë të gjallë polemike. Prof. R. Ismajli ka meritën që i pari i mori në dorë dhe i analizoi diskutimet e sesioneve shkencore të asaj kohe që ishin botuar nga procesverbalet e mbledhjeve në revistën Buletin i Institutit të Shkencave. Përsa i përket projekteve drejtshkrimore, vihet në dukje ndryshimi i drejtshkrimit të vitit 1949 që respektonte dualizmin e bazës dialektore por traktati ishte shkruar gegërisht, me atë të vitit 1951 i rishikuar mbas vërejtjeve por tashmë i shkruar toskërisht. Me këtë rast shënohet edhe ndikimi i ministrit të Shtypit, propagandës e kulturës që nga viti 1945 e më pas ministër i Arsimit Sejfulla Malëshova, ithtar i flaktë i toskërishtes si bazë e gjuhës letrare, nga vendimet e të cilit që në vitin 1946 gegërishtja filloi të hiqej nga librat e shkollave, ndërsa në 1951 abetarja edhe në shkollat e Veriut do të bëhej toskërisht. Që nga ajo kohë në Shqipëri erdhi duke u zgjeruar dhe përforcuar përdorimi i toskërishtes jo vetëm si gjuhë zyrtare e shtetit por edhe si gjuhë letrare, duke u shoqëruar me vepra të mëdha normative, si gramatika e fjalorë që kishin në bazë toskërishten, psh Gramatika e vitit 1949, Fjalori i 1954 etj.

Paralelisht me diskutimet e rrjedhat planifikuese që zhvilloheshin brenda kufijve të Shqipërisë, mbledhje të ngjashme për gjuhën letrare të shqiptarëve të Jugosllavisë zhvilloheshin edhe në Kosovë, për të cilat autori sjell dokumentet dhe analizat përkatëse të diskutimeve e propozimeve, të cilat gjithsesi përpiqeshin të standardizonin një gegërishte të përgjithshme që qëndronte mbi gegërishtet e përdorura në hapësirat shqipfolëse, të cilat do të bashkëpunonin duke mënjanuar “evolutat partikulariste të nëndialekteve të ndryshëm të gegënishtes”. Në këto përkufizime duket qartë ndikimi i konceptit të pangegërishtes së Selman Rizës që në atë kohë ishte në Prishtinë. Kjo tendencë, me ngritjet e uljet e veta, kundërshtitë e mospajtimet e pasqyruara në shkrime, diskutime e projekte të herëpashershme ortografike, vazhdoi deri në ortografinë e vitit 1964 që ishte e fundit e hartuar për gegërishten në Kosovë, por me një hap të madh përpara që ishte prirja për t’iu afruar sa më shumë zgjidhjeve drejtshkrimore të Tiranës. Ajo që shënoi kthesën në drejtshkrimet e hartuara në Kosovë ishte Konsulta Gjuhësore e Prishtinës e vitit 1968, e cila pasonte projektin e drejtshkrimit të shqipes të vitit 1967, që u botua edhe në Prishtinë dhe iu nënshtrua edhe atje një diskutimi të përgjithshëm, në një kontekst bashkëpunimi kulturor gjithmonë e më intensiv në ato vite mes Shqipërisë e Kosovës. Konsulta e Prishtinës u zhvillua nën parullën “Një komb - një gjuhë letrare”, fryma e së cilës kërkonte njësimin e gjuhës letrare dhe një ortografi të

përbashkët, që sipas vendimit të njëzëshëm të Konsultës do të ishin ato të shtetit amë. Konsulta i parapriu kështu Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, i cili me vendimet e tij të miratura njëzëri nga delegatët e ardhur nga të gjitha trevat shqipfolëse brenda dhe jashtë vendit, sanksionoi drejtshkrimin e njësuar të shqipes standarde, tashmë të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Në libër analizohet gjerësisht dhe me frymë kritike referati kryesor i mbajtur në kongres nga Androkli Kostallari, duke vënë në dukje dhe disa vlerësime të drejta të tij që i qëndrojnë kohës. Autori përcjell edhe kritikën e mëvonshme që i janë bërë Konsultës së Prishtinës, nga Sinan Hasani, Arshi Pipa, Tahir Kolgjini etj. dhe analizon edhe mendimet e Janet Byronit për planifikimin gjuhësor në Shqipëri.

Me fjalën përmbyllëse të studimit, autori arsyeton qëndrimin e Prishtinës për njësimin e gjuhës letrare shqipe me standardin e Tiranës me përpjekjet e bashkësisë shqiptare të Jugosllavisë për mbrojtjen e identitetit kombëtar, pra me luftën e saj për gjuhën si shenja kryesore dalluese e këtij identiteti.

